



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 25

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

Prishtinë, më 10 tetor 2018, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Enver Hoti, Drita Millaku, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu.

Munguan: Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Të ftuar: Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, z. Basri Ibrahimimi.

Pjesëmarrës tjerë: Valon Leci, Inspektorati i Punës; Florina Duli, IKS; Brikenë Hoxha, IKS dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, z. Basri Ibrahimimi
 - Temë diskutimi:
 - Siguria dhe shëndeti në punë;
 - Raportim për vdekjet në vendin e punës.
3. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 04/L -190 për produkte dhe pajisje medicinale;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Takim me kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, z. Basri Ibrahim

- Temë diskutimi:
- Siguria dhe shëndeti në punë;
- Raportim për vdekjet në vendin e punës.

Kryetarja, tha se ne si komision e kemi paraparë që në këtë takim, t'ju ftojme juve si kryeinspektor i Punës, duke pasur parasysh gjendjen aktuale në sektorin privat dhe rastet e fundit që kanë ndodhur me fatkeqësitë në vendin e punës. Jo vetëm ne si komision që jemi të shqetësuar me situatën që po ndodh me punëtorët, por i gjithë opinioni publik është i shqetësuar për rastet e vdekjeve në vendin e punës. Ashtu siç jeni në dijeni që, në këta muajt e fundit, ka raste të shumta të vdekjeve në vendin e punës. Dje ka qenë një protestë e organizuar nga shoqëria civile, të cilët me plot të drejtë kanë vendosur para Qeverisë 93 kapela, si simbolikë e vdekjes së punëtorëve në vendin e punës. Pra, nuk është duke u respektuar Ligji i punës dhe Ligji për mbrojtje dhe shëndet në punë.

Kështu që, sot, kërkojmë nga ju të na raportoni se si është gjendja. A keni bërë inspektime? Po besoj që rastet që ndodhin me fatkeqësi, jeni të obliguar që në momentin që ndodhin fatkeqësitë, të jeni të pranishëm si inspektorat. Çka keni ndërmarrë në këtë drejtim? A ka pasur raste të mbylljeve të vend-punishteve apo të punëtorëve, kur kanë ndodhë këto fatkeqësi? Sa po zbatohet ligji i punës, për të cilin jeni përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e tij, dhe ligji për siguri dhe shëndet në punë?

Basri Ibrahim, tha se do t'ju informoj për gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe gjithashtu edhe për çështjen e marrëdhënies së punës në përgjithësi. Ne, në këtë 8 mujorin e fundit, kemi bërë gjithsej 6 205 inspektime, prej tyre, 1 829 vërejtje, në bazë të konstatimit që kanë bërë në teren inspektorët dhe ua kanë dhënë kohën e eliminimit, sepse në bazë të ligjit mbi inspektoratit, ne jemi të obliguar që në momentin që e inspektojmë një kompani, konstatimet që i bëjmë, t'ju japim kohë për eliminim dhe pastaj shkojmë në ri-inspektim dhe shohim se si kanë vepruar. Nëse shohim që biznesi nuk i ka eliminuar të metat, atëherë i shqiptojmë gjokat. I kemi pasur 764 ankesa nga ana e palëve.

Në krahasim me vitin e kaluar, janë rritur ankesat që drejtohen në Inspektoratin e Punës dhe për këta 8 muaj e kemi tejkuluar numrin e ankesave që i kemi pasur në vitin e kaluar. Të gjitha këto ankesa, marrin përgjigjen ligjore, brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. 126 inspektime i kemi pasur në bashkëpunim me institucionet të tjera, kryesisht me Policinë e Kosovës. Prej tyre, kryesisht kemi hasur në punëtorë, pa kontrata pune, që është element i moszbatimit të ligjit të punës, dhe në këtë rast, i kemi lokalizuar 571 punëtorë. Prej këtyre vërejtjeve, ne i kemi shqiptuar 206 gjoka, që në krahasim me vitin e kaluar, janë 60 gjoka më tepër. Edhe numri i inspektimeve të përgjithshme, janë një mijë inspektime më shumë se në vitin e kaluar. Fatkeqësisht, për sigurinë dhe shëndetin në punë, tregon numri i aksidenteve dhe vdekjeve të rritura këtë vit. I kemi 18 vdekje si pjesë e kushteve të punës, 2 vdekje janë natyrore, që kanë ndodhë në vendin e punës.

Nga kjo, në ndërtimtari janë 10 raste, mirëpo edhe këtu ka dallim, nuk është krejt çështja e kushteve të punës dhe punëdhënësve, mirëpo ka edhe raste të tilla që ne i quajmë individuale, që kanë vdekur nëpunë shtëpi, duke ndërtuar shtëpi private individuale. Për dallim nga vitet tjera, që ndërtimtarinë e kemi pasur fokus nga muaji qershor deri në shtator, këtë vit kemi filluar qysh nga marsi dhe janë nda grupe të veçanta të inspektorëve që janë marr me inspektime në ndërtimtari, në këtë mënyrë kemi pasur 7097 inspektime në këtë sektor, duke u munduar që ta mbulojmë sa më shumë që është e mundur dhe që ta përmirësojmë gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë. Por, megjithatë gjendja nuk është ajo që duhet me qenë, por nuk është ashtu qysh e paraqesin, që nuk ka kurrëgjë, sepse megjithatë ka ndryshim të madh pozitiv edhe në qasjen e punëdhënësve, edhe në vetëdijen e punëtorëve, megjithatë nuk është në nivelin që ne dëshirojmë.

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, tha se sot po flasim për një rënë nga temat më me interes që kemi në shtetin tonë, për shkak se në 5 vitet e fundit janë shënuar 98 raste të vdekjes, mirëpo sidomos që në 10 ditët e fundit i kemi 2 viktima, tashmë një kryefamiljar po ashtu ka humbur jetën, ditë më parë, në sektorin e ndërtimtarisë, që tash më po shënohet si njeri nga sektorët më vdekjeprurës.

Unë kisha filluar nga numri i vogël i inspektorëve. Këtu, Qeveria po tregohet joserioze, në këtë drejtim, duke mos ndarë mjete të mjaftueshme buxhetore. Në anën tjetër, ka një numër tepër të madh të zëvendësministrave, këshilltarëve, koordinatorëve për të cilët po gjendet buxheti, por nuk po ka buxhet për rritjen e numrit të inspektorëve, që është domosdoshmëri.

Ne e dimë që ndërtimtaria sot është njëri prej bizneseve më fitimprurëse dhe shumë njerëz jo të thirrur kanë regjistruar biznese. Kriteret për regjistrimin e bizneseve duhet të ashpërsohen, sepse kur shkojmë të inspektimet preventive që duhet t'i bëjnë inspektorët, ne duhet të shohim se sa është e thirrur ajo kompani, ai biznes që të trajnojë punëtorët që i punëson e që kryesisht janë punëtorë të pakualifikuar. Shumë prej viktimave kanë pasur edhe fakultet, mirëpo kanë punuar si punëtorë të pakualifikuar në ndërtimtari dhe nuk mund të themi që prej pakujdesisë së tyre kanë vdekur. Aksidentet me fatalit janë në rritje e sipër dhe kjo është shumë shqetësuese për ne. Pyetja ime konkrete është të shqiptimi i gjobave, sa keni gjetur ju shkelje të dyfishta? A është mbyllur ndonjë biznes, për shkak të vdekjeve në vendin e punës? Ne, si Kuvend, duhet të bëjmë të pamundurën të kërkojmë buxhet shtesë në rritjen e numrit të inspektorëve, mirëpo për momentin e dimë që ju jeni aq sa jeni. Dëshirojmë të dimë se sa bëni inspektime preventive, në kuptimin e kërkesës që, a bëjnë bizneset trajnime për punëtorët kur i punësojnë? A ofrojnë/prezantojnë dokumentacion që janë kryer ato trajnime? A kanë njerëz të thirrur për t'i përgatitur ato trajnime? A i zbatojnë vetë masat që i obligon ligji për t'ua siguruar kushtet në vendin e punës?

Kam sjell sot një helmetë që nuk e ka më pronarin e vet dhe kjo është shumë shqetësuese. Ju e dini që familja e një punëtori që vdes aksidentalisht në vendin e punës, mbetet edhe e pasiguruar. Shteti duhet ta rregullojë që familja të gëzojë pension, nëse e humb kryefamiljarin e ajo familje të mos mbetet në mëshirën e fatit.

Andaj, ju lus të na tregoni, çfarë gjoba shqiptoni, çfarë karakteri janë? A janë aq të vogla që bizneset s'i llogarisin fare? Meqë nuk janë ndëshkimet e duhura, ata vazhdojnë me avazin e vjetër? A merrni masa, nëse nuk janë kryer trajnimet për punëtorë, sidomos për ata të

pakualifikuar? Cilët janë hapat që do t'i ndërmerrni për rritjen e numrit të inspektorëve? A po bëni presion te Qeveria në kërkesë, në mënyrë që edhe ne t'u mbështesim?

Enver Hoti, tha se është shumë më rëndësi që të kemi një takim të tillë me Inspektorati e punës, po ajo që dua të theksoj është se do të kishim pasur dëshirë të dëgjojmë për avancime dhe për një prosperitet në fushën e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, gjë që nuk e dëgjova, mirëpo dëgjova një raport në formë telegrafike për atë çka ka ndodhur në punishte dhe në çfarë gjendje po kalon punëtorja në Kosovë.

Fillimisht, ndoshta duhet që të shprehim ngushëllime për të gjithë familjarët që i kanë humbur të dashurit e tyre në vendin e punës dhe të ndajmë jo vetëm shqetësimin, por sigurisht ndajmë edhe dhembjen dhe ngremë kërkesat që inspektorati dhe institucionet, të jenë aktive, sepse ne po mendojmë që nuk është duke u zbatuar ligji. Këtu kemi temën, siguria dhe shëndeti. Për shëndetin në punë s'kemi çka të flasim, sepse nuk ekziston fare një trajtim i tillë, nuk mund të flasim as për mundësi profesionale, sepse s'kemi asnjë pasqyrë, nuk është as në horizont duke u trajtua ajo çështje. Pra, unë besoj ashtu dhe së paku po e them qëndrimin tim. Siguria, po shihet që është shumë minimale në vendin e punës dhe e përcjellë që nga themelimi i bizneseve dhe regjistrimi i tyre e deri te ju, që jeni kompetentë në përcjelljen e aktiviteteve të punëtorëve dhe organizatave punuese në terren.

Ankesat nuk janë një farë lloj sigurie që është shtuar besimi te inspektorati, duke u thirrur që kanë ardhur edhe rreth 700 kërkesa nga palët. Do të duhej që këtu ta kemi një informacion më të qartë, se për çfarë sigurie dhe për çfarë besueshmërie po flasim. Unë mendoj që institucioni juaj, nga ajo që ne kemi kontakte me punëtorët, me qytetarët, është i rrënuar, dhe jo vetëm te ju, po as te qeveria dhe as të ministria dhe jo vetëm me këtë Qeveri, mirëpo asnjëherë deri më tani. Kjo është gjendja dhe konstatimi që unë kam nga kontaktet me qytetarët, anembanë vendit. Nuk mund të ketë besim një punëtor i cili punon në një minimarket 15 orë. Është shumë interesant kur thoni që është shtuar numri i inspektiveve prej një viti në tjetrin. A është shtuar numri i inspektorëve apo pse?

Basri Ibrahim, tha se politika dhe Qeveria po çalon, është çështje që mua nuk më takon të flas. Por, inspektorët e punës janë unikë dhe të pandalshëm në punën e tyre. Ndërkaq, ndarjen e gjobave ne nuk e kemi mundësinë t'i ndajmë dhe klasifikojmë secilën, ngase inspektori shqipton gjobën edhe për trajnime, edhe për informim dhe pajisje me kontrata dhe për të gjitha, bashkërisht. Këtë vit e kam paralajmëruar nga fillimi që do të ketë gjoba më të ashpra. Ju siguroj që gjobat nuk janë të vogla, gjoba deri në 10 mijë euro qysh është me ligjin e punës dhe gjobat për sigurinë në punë deri në 35 mijë euro nuk i shqiptojmë, ngase gjithmonë duke u munduar të japim kontributin që bizneset të përmirësohen. Jemi mundur të vendosim një bilanc, në mes atyre të pandërgjegjshëm, duke mos shqiptuar gjoba, ka 15.000 -20.000 euro që ka qenë, ka edhe më të vogla, por jemi munduar edhe të bëjmë fushata vetëdijësuese, me spote në TV, me fletushka që përmbajnë gjithë të drejtat e punëdhënësit dhe punëtorit, krahas kësaj duke shkuar edhe me gjobë.

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, pyeti: A ka mundur inspektorati të identifikojë se qysh dhe si e kanë humbur jetën punëtorët? Nga hedhja nga ndonjë lartësi, për shkak se punëtori nuk ka qenë i siguruar apo për çfarë?

Basri Ibrahimi, tha se rasti i fundit është se punëdhënësi ka rënë nga lartësia dhe jo punëmarrësi. Këtë vit janë 1000 inspektime më shumë, ngase ne kemi shkuar në reduktimin e disa kërkesave, me kërkesa më të vogla, me qëllimin e vetëm që të përfshijmë më shumë biznese. Nëse i keni parasysh procedurat që i ndjekim, nuk ka mundësi të bëjmë më shumë inspektime të tilla, se duhet nxjerrë edhe vendime.

Këtë vit e kemi bërë edhe certifikimin e personave nga siguria dhe shëndeti në punë, e në bazë të ligjit, secila kompani që ka mbi 50 persona, duhet ta ketë një person të ngarkuar nga siguria dhe shëndeti në punë.

Gjithashtu, deri në këtë vit kemi pasur një defekt të madh, sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë, se punëdhënësit kanë qenë të obliguar të bëjnë vlerësimin e riskut, në vendin e punës, mirëpo nuk kanë pasur njerëz profesionalë, të cilët kanë mundur t’iu ndihmojnë të bëjnë vlerësimin e riskut, sepse jo gjithkush mundet ta bëjë. Prandaj, tash janë licencuar 6 kompani private, të cilat merren me vlerësimin e riskut në vendin e punës. Sa i përket çështjes së ankesave, nuk mund t’i ndajmë plotësisht, sa janë privatë e sa janë nga sektori publik, mirëpo mund të them me kompetencë shumë të madhe, që janë mbi 80 % nga sektori privat.

Naser Rugova, tha se është mirë që Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale+ është bashkë me juve, si institucion kyç për sigurinë në punë, sepse kjo është e vërteta e sotme edhe nga rezymeja e juaj, por edhe nga kolegët e mi deputetë, është një konstatim që vërtet gjendja në këtë sektor nuk është siç dëshirojmë. Unë bëj apel edhe institucional, edhe kolegjial, që ne si komision funksional parlamentar, që ta monitorojmë këtë fushë tejet të rëndësishme.

Unë do të bëjë apel që me plotësim-ndryshimin e ligjit, ne të gjithë deputetët, pa marrë parasysh përkatësinë politike, të angazhohemi maksimalisht. Po më gëzon fakti që janë 6 kompani private të certifikuar. Thjesht, kërkoj nga ju që t’ju jepni mbështetje, t’ju krijoni hapësirë këtyre ekspertëve të certifikuar. Ne nuk jemi ekspertë të asaj fushe, por si deputetë dhe si komision, që e thotë fjalën përfundimtare të plotësim-ndryshimit të ligjit, ne duhet t’i mbështesim këto biznese të sektorit privat, që të japin paga dhe mbajnë familje të tëra në Kosovë, mirëpo siç e tha njëra nga koleget këtu, jeta e njeriut është më e çmueshme.

Basri Ibrahimi, pajtohet se është përgjegjësi e punëtorit, absolutisht me shumë keqardhje për gjithë ata njerëz, por për këtë çështje t’iu bëhet apel punëtorëve, që ata të jenë më të përgjegjshëm në punën e tyre. Absolutisht, unë thashë që në fund të fundit, krejt barrën kryesore e mban punëdhënësi.

Te çështja e vlerës së jetës së njeriut, ne nuk shqiptojmë gjohë nga vlera e njeriut, sepse unë besoj se jemi të gjithë të vetëdijshëm që një jetë e njeriut s’ka asnjë vlerë monetare. Gjoha shqiptohet në bazë të asaj që konstaton inspektori në terren, se çfarë kushtesh nuk iu ka përmbajtur nga siguria dhe shëndeti në punë, e jo nga çështja e jetës së një njeriu, sepse nuk dua të dalë nga këtu me këtë mendim, që ne po e vlerësojmë jetën e njeriut.

Ne, në rast të vdekjes dhe aksidentit, jemi bashkë me prokurorët dhe me policinë. Çështja se në pyetjen tuaj se sa ka ngritur prokuroria kallëzime penale, a kanë dënuar ndonjë person apo s'kanë dënuar, kjo nuk është çështje që ne mund t'u japim përgjigje.

Besa Baftiu, tha se po e shqyrtojmë mundësinë që ta bëjmë një tryezë, me të gjithë institucionet, për këtë çështje.

Enver Hoti, tha se pyetja ime ishte kështu, raportet e juaja, sa janë të rrëzuara nga prokuroria, po më intereson nga ana profesionale e juaja?

Basri Ibrahim, tha se nga ana profesionale, me një përqindje ndër 10 për qind, bile edhe më pak, që vendimet e IP të rrëzohen qoftë nga gjykata, qoftë nga prokuroria. Ngase, prokuroria bazohet në raportet tona, sa herë hapë rast dhe kryesisht bazohet në raportin e inspektorit gjatë inspektimit të aksidentit.

Flora Brovina, tha se tema, të cilën po e shqyrtojmë, nuk mjafton vetëm prezenca e inspektoratit të punës, sepse ka qenë dashur të kemi edhe përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ndoshta përfaqësuesi i Këshillit Ekonomiko-Social, Shëndetësisë, pastaj ndoshta odat ekonomike dhe të tjerë, sepse nuk është një temë që mund ta përfundojmë vetëm me takime me ju, sepse po shihet që tema prej mandatit në mandat, përcillet gati e njëjta, mungesa e numrit të inspektorëve dhe kjo nuk mjafton.

Situata nuk është përmirësuar, ashtu siç është kërkuar nga ky komision për rritjen e numrit të inspektorëve dhe natyrisht ata të kenë arsimim të vazhdueshëm për inspektim. Nuk mund të jemi të kënaqur, sepse për çdo ditë i takojmë punëtorët dhe jemi adresë e ankesave të tyre. Ata shfrytëzohen jashtë orarit të punës, nuk kanë pushime ditore dhe vjetore.

Nuk mendoj që gjobat e zgjidhin çështjen, duhet vetëdija. A mendoni se një çështje që e di, sigurisht se nuk kemi momentalisht punëtorë të kualifikuar, sidomos në sektorin e ndërtimtarisë, ngase ata të kualifikuarit, gjejnë punë edhe jashtë. E dyta, po më intereson ju si inspektorat, përveç me ministri, a bashkëpunoni edhe me Këshillin Ekonomiko-Social, edhe me sindikalistë, a e dëgjoni fjalën e tyre, do të thotë të sindikalistëve dhe të punëdhënësë në këtë këshill? A jeni ftuar ndonjëherë që të përgjigjeni se çka po ndodh, në bazë të raporteve që i keni nga terreni?

Besa Baftiu, tha se unë pajtohem me atë që duhet të jenë të gjithë aktorët, sepse nuk mund të zgjidhen vetëm me praninë e kryeinspektorit të punës, mirëpo unë po mendoj që është shumë më e mirë një tryezë ta bëjmë të përbashkët, ku do t'i ftojme të gjithë aktorët, ngase edhe koha që do të diskutojmë në komision, është e pamjaftueshme, kur i kemi prezent pesë apo gjashtë aktorë të ndryshëm. Unë po propozoj që ta mbajmë një tryezë të përbashkët, e që po besoj që për këtë do të gjejmë mbështetje nga partnerët tanë, të cilët në vazhdimësi na kanë mbështetur.

Basri Ibrahim, tha se Inspektorati i punës i ka 42 inspektorë efektivë do të thotë që i kemi sot. A është numri i mjaftueshëm? Sigurisht, që nuk është, por nuk është çështja vetëm te numri i inspektorëve, por ka edhe pengesa të tjera, edhe logjistike, teknike ka mjaft mungesa të tjera që

ne, gjithmonë i kemi shtruar këto çështje. Mirëpo, ne e kemi mirëkuptuar edhe buxhetin e të gjitha këto. Natyrisht, që ne nuk jemi të dalim dhe të bëjmë bujë jashtë, mirëpo ne jemi që të merremi vesh me institucione, se çka ka mundësi për t'u rritur.

Drita Millaku, tha se gjendja e sigurisë në punë, është shumë e rëndë. Ju po thoni që më shumë po ekzagjerohet nga media, jo pse të mirë se na kanë informuar për rastet, por është informimi i drejtpërdrejtë me rastet tragjike, që janë duke ndodhur në vendin tonë. Është për keqardhje se kaluan 20 vite, pas luftës dhe ne kemi vdekje më të shpeshta se kurë më parë, edhe në trafik, por edhe në vend të punës, kjo është për keqardhje. Desha të pyes, a janë duke u ndëshkuar, përveç gjobave edhe në forma të tjera, mbyllja e këtyre firmave apo kompanive?

Ne e kemi një rast ende të freskët në Komunën e Prizrenit, rastin e humbjes së jetës së një 17 vjeçari, në vendin e punës, dhe përpos që e ka humbur jetën, ai e ka humbur në një gjendje jashtëzakonisht tmerruese.

Çfarë hapash konkretë keni marrë për atë kompani? Ju thatë që i keni raportet shumë të mira bashkëpunuese, sa i përket prokurorisë dhe gjykatave, mirëpo në realitet nuk po shihet një gjë e tillë, sepse akoma nuk kemi diçka konkrete për një firmë apo kompani që e keni mbyllur, për shkak të rasteve tragjike. Si kryeinspektor, a keni menduar ndonjëherë të jepni dorëheqje nga kjo punë, ngase gjërat nuk po shkojnë ashtu qysh po mendon dhe qysh duhet me qenë.

Basri Ibrahimi, tha se sa i përket pyetjes për dorëheqje, nuk e di a duhet të japësh ti dorëheqje, si deputete, a unë si kryeinspektor? Nuk thashë mediat që nuk kanë kontribuar. Përkundrazi, me media jam shumë i kënaqur dhe raporti i inspektorati me media është shumë korrekt dhe shumë profesional.

Sa i përket rastit konkret që biseduam, ne i kemi kryer të gjitha veprimet ligjore ndaj kompanisë në Prizren, që për ne ka qenë rasti më tragjik, më i rëndë. Ne e kemi ndjerë edhe si njerëz, edhe si shoqëri, edhe si pozicion. Janë kryer të gjitha detyrimet ndaj tyre, ka qenë edhe përkohësisht i pezulluar nga puna në atë sektor ku ka ndodhur rasti tragjik, edhe gjoba është shqiptuar nga spektri i inspektoratit. Ne i kemi kryer të gjitha veprimet tona.

Drita Millaku, tha se nuk thashë në aspektin që ti je fajtor apo përgjegjës për gjithë situatën, por kur i sheh që gjërat nuk po mund t'i shtysh përpara, dikush duhet të filluar prej vetvetes. E sa i përket dorëheqjes sime, unë jam deputete e zgjedhur e popullit, nuk jam e emëruar.

Basri Ibrahimi, tha se sikur unë ta ndija që unë jam fajtori, unë jam pengesa dhe që dorëheqja ime ka do ta ndryshojë situatën, të jesh e sigurt, që tash, në këtë moment kisha dhanë dorëheqje.

Drita Millaku, theksoi se dikush duhet të fillojë.

Basri Ibrahimi, tha se filloni ju të rrisni numrin, shtoni buxhetin, dhe në qoftë se nuk përmirësohet situata, duhet reflektuar. Por, ju e keni pasur mundësinë për ta rritur buxhetin. Kur të rritet numri, krijohet mundësi e mirë për të zhvilluar një fushatë vetëdijësuese. Ne jemi duke i bërë disa fushata të zbehta, sepse nuk kemi buxhet.

Bekim Haxhiu, pyeti: Sa është dënuar kompania në Prizren për këtë rastin?

Basria Ibrahimimi, tha se nuk e kam idenë tash, nuk e di se janë shumë biznese dhe nuk mund të jap përgjigje për këtë rast, tani.

Bekim Haxhiu, tha se dua ta ndaj me juve këtë video, besoj që e ke parë, sepse ka qenë në një rën prej mediave tona, këto janë kushtet se ku punohet. Ky është kati i 13-të, asnjë mburojë, punëtori është jashtë, i dalë, do të thotë nuk po them që bash janë të gjitha kështu, mirëpo diku rreth 80% e vend punishteve janë në këtë formë. Sot, i nderuar kryeinspektor, ju kemi thirrur vetëm për temën për siguri e shëndet në punë dhe jo për temat e tjera, si: shkeljet e të drejtave të tjera të punëtorëve dhe rastet tjera, se për këto, kemi debatuar në Kuvend, dy herë brenda vitit. Do të thotë, Kuvendi i Kosovës, duke e parë edhe ne si deputetë shqetësimin tonë për shkeljet e të drejtave të punëtorëve edhe për rastet e vdekjes, të cilat kanë ndodhur në vendin e punës, i kemi thirrur dy debate, një prej debateve e kam iniciuar me kolegen Xhevahire Izmaqu dhe pastaj edhe një debat tjetër, i cili është mbajtur dhe disa rekomandime janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Njëri nga këto rekomandime ka qenë shtimi i numrit të inspektorëve dhe rritja e kapacitetit të Inspektoratit të punës, për të qenë në shërbim, sepse mendoj që asnjë çmim tjetër nuk është më i vlefshëm se jeta e njeriut. Do të thotë, nuk ka çmim apo ndonjë buxhet, të cilin duhet kursyer për të arritur deri tek ajo, për të krijuar siguri dhe shëndet në punë.

Ligji për siguri dhe shëndet në punë, është ligj i mirë nëse zbatohet dhe respektohet, mirëpo në shumicën e rasteve as nuk respektohet nga punëdhënësit, nganjëherë, as nga punëmarrësi. Unë nuk jam i kënaqur hiç me punën e Inspektoratit të punës, sa i përket këtyre mbikëqyrjeve, raporteve edhe vlerësimeve.

Prej 93 raste të vdekjeve në vendin e punës, sa është numri i kallëzimeve penale ndaj punëdhënësve për mosrespektim të masave të sigurisë në punë? Sepse, ne nuk mundemi të ndalim vdekjen në punë, për shkak të mosmarrjes së masave adekuate për siguri në punë, nëse nuk ka dënime edhe kallëzime penale nga prokuroria.

Të zbatimi i ligjit, kontrollet mjekësore, a keni vërejtje? Sepse, çdo punëdhënës është i obliguar të bëjë kontrolle mjekësore për të punësuarit e tij, së paku një herë në tri vite, do të thotë unë jam i bindur, sepse kur s'i ndërmerret këto masa për siguri në punë edhe kontrollet mjekësore që nuk vijjnë në shprehje dhe në kompanitë, ku janë mbi 50 punëtorë deri në 250, duhet të jetë një ekspert i fushës së sigurisë.

Brenga jonë kryesore janë vdekjet dhe lëndimet në punë dhe kjo nuk ndodh vetëm në ndërmarrjet private, por edhe publike. Ju e dini rastin e të lënduarve në KEK, vdekjet e punëtorëve në Trepçë dhe kur institucionet publike, dhe ju e dini që sipas ligjit, neni 15, çdo vend pune duhet ta ketë dhënien e ndihmës së parë. A e dini z. Ibrahimimi që as Kuvendi nuk ka?

Basri Ibrahimimi: Do të thotë edhe këtu të vijë inspektorati për të inspektuar për të mbrojtur jetën e punëtorëve?

Bekim Haxhiu, tha se normal, që duhet mbrojtur jetën e punëtorit, kudo i nderuari Ibrahimimi, ku nuk e zbatojnë ligjin, kudo. As qendra e fitnesit nuk e ka pasur ndihmën e parë që t'ia japë Fadil Vokrrit, nuk ka pasur defibrilator. Nesër, mund të kemi raste të tilla edhe në Kuvend. Të jeni të bindur, që 90 % të institucioneve publike nuk e kanë dhomën e ndihmës së parë. Se për vend

punishte e ndërtimtari s'po flasim, kur s'kemi në institucione publike, atëherë sigurisht as për vend punishte nuk mund të flasim.

Besa Baftiu, tha se unë dua të ngre një çështje, që është korrupsioni, në kuadër të punëtorëve të Inspektoratit të Punës. Ju thatë se jeni të kënaqur me performancën e punëtorëve tuaj, duke pasur parasysh që këtë vit është rritur, siç thatë, janë 1,000 inspektime më shumë, por ne kemi të dhëna se një inspektor i juaj, i/e korruptuar është dënuar vetëm me kusht dhe ka mundësi të kthehet në vendin e punës. Përflitet që shkaku kryesor është numri i vogël i inspektorëve, mirëpo shkaku kryesor është arsyeja që nuk mund të inspektohen të gjitha vend punishtet, por edhe një tjetër që është korrupsioni.

Ka aq shkelje drastike, s'di a jeni të informuar që në kompaninë vendore "TREFARM", e cila po largon 9 punëtorë prej punës dhe e marrin një pronar tjetër, të një kompanie tjetër, i cili vjen në "TREFARM" me 9 punëtorë të tjerë. Besoni se asnjëri prej tyre nuk është ankuar në inspektorat. A është arsyeja se ka humbur besimi edhe në inspektorat edhe në gjyqësi? Raste të tilla të shkeljes flagrante të drejtave të punëtorëve janë me qindra e me mijëra dhe ju si kryeinspektor e mbani përgjegjësinë, së paku për punëtorët që ju japin llogari.

Bekimi Haxhiu, tha se rasti i largimeve kolektive të punëtorëve të KEDS-it, ata janë ankuar në shkallën e parë dhe të dytë. A mund të na sqaroni si kryeinspektor, të tregoni se cilat kanë qenë vendimet e juaja, sepse ju i keni udhëzuar që pas shkallës së dytë, për të shkuar në gjykatë?

Basri Ibrahim, tha se sa për korrupsion, s'kisha dashur të dëgjoj prej juve deputetëve, sepse më duket shumë oportune kjo punë, nëse keni dëgjuar për një rast, ju lutem shumë, për inspektorin e punës, për të cilin ju po flitni, ai është i pezulluar.

Unë si kryeinspektor i kam marrë të gjitha veprimet ligjore, sa i përket pjesës tjetër të korrupsionit të inspektorëve.

Çështja e gjobës, se çfarë i shqipton inspektorati, është çështje e bazuar në ligj.

Në shëndetësi, asnjëherë nuk kemi shkuar me dëshirën tonë ose me iniciativën tonë për inspektim, vetëm me ankesa. Gjobat janë ato çfarë janë dhe pastaj ekziston mundësia ligjore për ta kontestuar vendimin e inspektoratit nëpër gjykata dhe nëse gjykata e bie vendimin që ne kemi gabuar, natyrisht që ne e zbatojmë këtë.

Te punëtorët e KEDS-it, unë për rastin individual nuk dëshiroj të flas shumë. Për rastin e punëtorëve të KEDS-it, ne e kemi nxjerrë vendimin tonë ligjor dhe ia kemi shpallur të bazuar ankesën e të gjithë atyre punëtorëve, e kemi shqiptuar gjobën, që është dashur të shqiptohet. Gjopa nuk është më esenciale, esenciale është a ia jap të drejtën punëtorit apo nuk ia jep. Vendimi ligjor e krijon bazën për të shkuar në gjykatë. Punëtorët nuk kanë pasur fare nevojë për të bërë padi, është dashur vetëm ta dërgojnë vendimin tonë për ekzekutim, nuk ka nevojë të hapet tjetër procedurë. Vendimi i inspektoratit është dashur të dërgohet në gjykatë për ekzekutim dhe ai deri tani ishte dashur të përfundojë.

Bekim Haxhiu: Po ia filloj prej fundit. Afatin ligjor KEDS-i e ka prapë, pra punëtorët e KEDS-it që ta dërgojnë për shqyrtim.

Basri Ibrahim: Jo, më fal, në momentin që ne e bëjmë të plotfuqishëm vendimin, ata kanë të drejtë. Ne mund të shqiptojmë vetëm gjobë, s'kemi mekanizma të tjerë detyrues. Tash, ata, atë vendim e dërgojnë në gjykatë dhe gjykata e shqyrton. Këtu përfundojnë procedurat tona.

Bekim Haxhiu, tha se sipas asaj që unë e di, ndoshta ju e dini më mirë, dënimi i KEDS-it ka qenë 10 mijë euro për 95 punëtorë, që i bie 105 euro për një punëtor. Ky është dënimi?

Besa Baftiu, tha se kemi edhe shumë gjëra tjera për të diskutuar, sa i përket edhe ligjit të punës, por po besoj se edhe herëve të tjera do t'iu kemi në takim. Ne, si anëtarë të komisionit dhe si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e kemi mundësinë ta ngremë zërin, sa i përket buxhetit që ka të bëjë me rritjen e numrit të inspektorëve. Besoj që secili prej neve duhet jo vetëm në komision, por edhe në Kuvend, ta ngremë zërin dhe të jemi unikë, që numri i inspektorëve duhet të rritet.

Bekim Haxhiu, tha se nëse më lejohet, vetëm për fund, zoti Ibrahim dhe e nderuar kryetare, jemi në fazën, ku do të thotë përgatitet buxheti për vitin e ardhshëm 2019 dhe projeksionet tjera buxhetore. Unë po kërkoj prej juve, që kërkesat e juaja buxhetore, nëse nuk merren parasysh në Qeveri apo institucion apo instanca tjera, do të thotë të jeni këtu me neve në komision, kur të bëjmë shqyrtimin e buxhetit për vitin 2019. Ne jemi të gatshëm që si komision t'i mmbështesim kërkesat e juaja për shtimin e numrit të inspektorëve edhe për shtimin e kapaciteteve logjistike dhe ato për trajnime që ju keni planifikuar.

Kryetarja, tha se në mungesë të kuorumit për të vazhduar mbledhjen, po e përfundojmë mbledhjen dhe do ta vazhdojmë javën e ardhshme, me pikat tjera.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU